

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR
"Fantasy Design " SHPK**

Ne Tirane, sot më date 05/06/2024 në selinë e shoqërise, me zyrë në adresën: Rruga Kongresi I Lushnjes, Ndertesa nr. 1, Tiranë u paraqit personalisht ortaku themelues si më poshte: Z.Fisnik Kullafi, shtetas Shqiptar, atësia Sherif, lindur më 08-05-1992 në Librazhd dhe banues ne Tirane, madhor, me zotësi të plote juridike dhe per të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim me Nr. Personal J20508074J, I cili harton këtë Akt Themelim të Shoqërisë "Fantasy Design" SHPK, mbështetur ne ligjin 9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare", i ndryshuar, ligjin 9723 date 03.05.2007 Për Qëndren Kombetare të Biznesit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si më poshte:

KREU I

**Neni 1
Krijimi**

Shoqëria "Fantasy Design" SHPK, është person juridik i të drejtës shqiptarë, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

**Neni 2
Personaliteti iuridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qëndrën Kombëtare te Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj. Shoqëria "Fantasy Design" SHPK. është një shoqëri, që themelohet nga ortaku i vetëm Z. Fisnik Kullafi i cili përballon humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij ne kapitalin themeltar.

**Neni 3
Selia**


Shoqëria e ka selinë në Rruga Kongresi I Lushnjes, Ndertesa nr,1 ,Tirane. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyrë përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut/Ortakëve te Shoqërise.

**Neni 4
Objekti i veprimtarise**

Objekti i veprimtarise së kësaj shoqërie është:

Kryerjen e aktivitetit per pergatitjen e produkteve reklamuese, etj., si per llogari te vet ashtu dhe per te tretet.

Neni 5



Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një perludhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000 leke (njëmijë lekë). a) Ortaku Fisnik Kullafi është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale 1.000 lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo te drejta). Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shperblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7 Menyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave


Kuotat e kapitalit, të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përrcaktuar miratimin e shoqërise ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërise apo të ortakëve të tjerë. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësive mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagësës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk për kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontrates. Me perjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmeria e kalimit të titullit të pronësive mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e Biznesit ose të publikimit të kontrates apo të kalimit të titullit.

KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE



Neni 8 Organi vendimmarrës

Asambleja e Ortakut/Ortakëve të vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakut/Ortakëve të vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja Ortakut/Ortakëve të vetëm është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë

për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ccurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfagësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) Kreditimin në çfaredo bankë apo institucion financiar kreditor.
- n) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.


Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i trete.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asambletë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator Z. Fisnik Kullafi, shtetas Shqiptar, atesia Sherif, lindur më 08-05-1992 në Librazhd dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim me Nr. Personal J20508074J, sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripertëritje. Asambleja e ortakut/ortakëve të vetëm mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Përvojë kësaj, administratori shkarkohet nëse eivkata në shkëlqim të ligjit me kërkesë të çdonjerit prej ortakëve. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emerimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person jashtë ortakërisë



Neni 10 Kompetencat

Administratori ka të drejte e detyrohet te:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) perfaqesojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë: bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së
- d) përgatiti dhe nënshkruajë veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportojë përpara asamblesë së ortakut/ortakëve të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligje dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara Taksave, Zyrave të Qeverisjes Vendore, Zyrave të Punes, Autoriteteve Doganore, etj, . në të gjitha Bankave të të gjitha niveleve, për të kryer derdhje, tërheqje, transfera, etj, përpara Zyrave të Tatimit rrethanat me përjashtim të kompetencave as listat më të mëdha të ortakëve të shoqërisë Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë përputhje me objektin e saj.


Neni 11 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13 Mosmarrëveshjet



Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nen për nen nga Ortaku i shoqërisë tregëtare " Alb Investment Group "shpk, dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË
" Fantasy Design " SHPK

Fisnik Kullafi

